



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 18, datë 02.04.2026



**PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KËSHILLIT KULTUROR,  
ARTISTIK DHE SPORTIV PËR PERIU DHËN 2026-2028**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturor”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028”, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ngritjes së Këshillit Kulturor, Artistik dhe Sportiv pranë Bashkisë Durrës, me mandat 2 (dy) vjeçar, për periudhën 2026-2028, me përbërje si më poshtë:
  1. Migena Muhaj – Drejtor, Drejtoria Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare
  2. Haig Zacharjan – Kompozitor
  3. Shpresa Beqiraj – Piktore
  4. Aldo Aliaj – Koreograf

- |          |       |             |
|----------|-------|-------------|
| 5. Haxhi | Rama  | – Regjisor  |
| 6. Bujar | Qesja | – Gazetar   |
| 7. Orges | Mema  | – Dirigjent |

2. Miratimin e shpërblimit për çdo anëtar të Këshillit në shumën prej 3500 (tremijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit do të përballohet nga fondi i parashikuar në buxhetin vjetor të Bashkisë Durrës.
4. Ky këshill do ketë karakter këshillimor me mandat dy vjeçar dhe do të mblidhet jo më shumë se gjashtë herë në vit.
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 148, datë 28.09.2023 “Për miratimin e krijimit të Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, shfuqizohet.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 03.04.2026**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 246 / prot.  
8

Durrës, më 08.04 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës

KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.18 datë 02.04.2026 ,”Për ngritjen, funksionimin dhe përbërjen e Këshillit Kulturor, Artistik dhe Sportiv për periudhën 2026-2028”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ADRIAN GURRA

